



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
 - AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 - ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dnp. \_\_\_\_\_  
 Nr. I faq \_\_\_\_\_  
 o. o. j. stranica \_\_\_\_\_  
 Nr. pages \_\_\_\_\_

Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
 Br. Prot. \_\_\_\_\_  
 Prot. No. 03-3470/10  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum \_\_\_\_\_  
 Date 19.10.2010

PRISHTINE



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
 GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL  
 MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, përmes Gjyqtarës **Salihe Berisha – Ahmetaj** me sekretarin juridik Naim Thaqi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Myzafere Kadrush Limani nga Prishtina, Rr.e Zagrebit ,nr 21 për shkak të kundërvajtjes nga neni 16 ,paragrafi 1.1 , e në lidhje me nenin 6 paragrafi.2 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe të dhuratave të zyrtarve te larte publike, në bazë të nenit 37 dhe 195 , të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën **30.09.2010**, harton këtë

Nr.regj.16963/2010

**A K T V E N D I M**

E pandehura **Myzafere Kadrush Limani**, e lindur më 15.11.1954 në Pejë, ingjinierë elektike dhe kompjuterike,e punesuar ne fakultetin Elektroteknik ,mban postin e Dekanes se ketij fakulteti, e martuar,nene e kater femijve ,e gjendje së mesme ekonomike ,e pa denuar më pare për kundërvajtje ,nuk është nën hetime,me vendanim ne Prishtine,rruga e Zagrebit nr21.,

**Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S E**

Sepse deri me daten 31.03.2010 ,ne Agjensionin kunder Korrupsionit ne Prishtine nuk ka deklaruar pasurine ,per vitin 2009 .  
 - me çka e pandehura ka kryer kundërvajtjen nga neni 16 ,paragrafi 1.1 , e në lidhje me nenin 6 paragrafi.2 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe të dhuratave te zyrtarve te larte publike, andaj në bazë të dispozitave të të njejtit Ligj

**D Ë N O H E T**

**ME DËNIM NË TË HOLLA** në shumën prej **800 €**, të cilin denim e pandehura është e obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktvendimi, e nëse pagesen nuk e bën në afatin e cekur, dënimi me të holla ka për t'iu zëvendësuar më denim burgu në kohëzgjatë prej **30 ditësh**, duke llogaritur një ditë burgu me 15 €. Obligohet e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 €, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm .  
 Dënimin dhe paushallin gjyqësor e pandehura e paguan në këtë gjykatë .  
 Me nga një kopje të Aktvendimit të njoftohen e pandehura dhe parashtruesi i kërkesës .

**A r s y e t i m**

**Agjencia kunder Korrupsionit**, me kërkesën nr.01/2309/10,të dates 15.06 2010 ka propozuar që kundër të pandehures, të zhvillohet procedura kundërvajtëse, të shpallët përgjegjëse dhe të ndëshkohet në bazë të Ligjit, për shkak të kundërvajtjes të përshkruar në dispozitiv.  
 Sipas kërkesës së parashtruar është zhvilluar procedura kundërvajtëse kundër të pandehures Myzafere Kadrush Limani ,i cila mbrojtjen e paraqitur pranë kësja gjykate e pranon faktin se ne afatin ligjor nuk e ka deklaruar pasurine duke menduar se posti I saj si dekan e fakultetit nuk hyn ne radhen e postit te zyrtarit te larte public  
 ,se sherbimi juridik I Rektoratit nuk e ka njohtuar fare se sipas Ligjit e per shkak te postit qe e mban eshte e obliguar qe ne Agjencine kunder Korrupsionit ta deklaroj pasurine dhe shton se sekretarja e saj me daten 30.03.2010 e ka njohtuar me me kerkesen e Agjencionit kunder korrupsionit ,per deklarimin e pasurise,se ne aten e cekur me larte dhe ditet pasuese ka qene shume e nxene me pune prandaj nuk ka pas kohe per te plotesuar formularin ndersa deklarimin e pasurise e ka bere pas dates 31.03.2010 por kete Agjencioni nuk e ka marr ne considerate prandaj ka inicuar proceduren kundervajtese ndaj saj ,se ne cilesine e proves materiale do te sjell posten elektronike qe nga Agjensioni anti korrupsion i eshte drejtuar sekretares se Rektoratit nga e cila shifet se Agjensioni I cekur si me larte me daten 25.03.2010 nga ky sherbim ka kerkuar qe te zyrtaret public gjegjesisht rektori dekanet dhe prodekanet e Univerzitetit Publik te njohtohen per afatin e fundit per deklarimin e pasurise.  
 Pas shtjellimit të provave gjatë procedurës, shiqimit të të dhënave në kërkesë dhe deklaratës së të pandehures gjykatësja ka fituar bindjen e lirë se e pandehura është përgjegjëse për kundërvajtjen e sanksionuar sipas nenit paragrafi 1.1 e në lidhje me nenin 6 paragrafi.2 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe të dhuratave te zyrtarve te larte publike, sepse deri me daten 31.03.2010 ,ne Agjensionin kunder Korrupsionit ne Prishtine nuk ka deklaruar pasurine ,per vitin 2009 , prandaj duke marr parasysht tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në shqiptimin e drejtë të dënimit Ligjor, duke pasur parasysht se dënimi i shqiptuar do të ndikoi pozitivisht që në të ardhmen mos të kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme, i shqiptoi dënimin me të holla , andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.  
 Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 109 të Ligjit mbi kundërvajtjet.  
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
 Nr. 16963/2010 të dates 30.09.2010

**GJYKATËSJA**  
**Salihe Berisha – Ahmetaj**

*(Signature)*

**UDHËZIME MBI MJETIN JURIDIK** Kundër këtij aktvendimi të drejtë ankese kanë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës , Gjykatës së Lartë për kundërvajtje ne Prishtinë,në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi përmes kësaj gjykate ,pa pulla.